

Përfshirja e shoqërisë civile të serbëve të Kosovës në politikëbërje

Më 29 qershor 2016, Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për zyrtarë qeveritarë, përfshirë kryeministrin dhe ministren për dialog, si dhe një numër përfaqësuesish të shoqërisë civile të serbëve të Kosovës. Qëllimi i takimit ka qenë diskutimi i ideve rreth përfshirjes së shoqërisë civile të serbëve të Kosovës në diskutimet dhe bërjen e politikave, si dhe rreth angazhimit të tyre të shtuar në çështjet e dialogut të Brukselit.

Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit më të gjërë mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës dhe të implementuar në bashkëpunim me ta.

Pikat e paraqitura më poshtë janë të bazuara në diskutimet e tryezës së rrumbullakët dhe nuk janë rishikuar nga pjesëmarrësit. CIG bartë përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e tyre.

- Kodi telefonik i Kosovës, marrëveshja mbi energjinë, hapja e urës kryesore në Mitrovicë, dhe krijimi i Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe janë çështjet kryesore të dialogut të Brukselit të cilat nuk janë implementuar ende. Marrëveshja mbi gjyqësorin është në implementim e sipër.
- Zyrtarët qeveritarë kanë thënë se pa kodin telefonik, energjinë, dhe shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë nuk do ta krijojnë Asociacionin/Komunitetin. Megjithatë, ata thanë se ekipi menaxhues tashmë është formuar dhe do të fillojë ta hartojë shumë shpejtë statutin. Për më shumë, qeveria do ta formojë një ekip tjetër i cili do të merret me shpërbërjen e strukturave paralele. Një folës është ankuar duke thënë se edhe tri vite pas marrëveshjes, qeveria ende është duke punuar në statut, por një zyrtar qeveritar është përgjigjur duke thënë se ekzistenca e institucioneve paralele po e vonon procesin dhe se shpërbërja e tyre është parakusht i panegociueshëm për krijimin e Asociacionit/Komunitetit. Një folës ka propozuar që të përgatitet korniza ligjore për Asociacionin/Komunitetin dhe që shpërbërja e institucioneve paralele të bëhet po të njejtën ditë.
- Strukturat paralele nuk do të duhej të shpërbëheshin para se të gjendet një model për integrimin e tyre. Shumë folës kanë thënë se strukturat paralele ekzistojnë për arsye praktike, e jo politike. Ato ofrojnë shërbime, siç janë shpërndarja e pensioneve, shërbim të cilin nuk e ofron asnjë institucion tjetër. Për më shumë, me mbylljen e tyre, më shumë se 5,500 njerëz do të humbin vendet e tyre të punës. Së këndejmi,

shumë folës kanë thënë se mbyllja e institucioneve paralele do të shkaktonte kaos, panikë, dhe shumë njerëz do të largoheshin nga Kosova, duke shkaktuar kështu dezintegrimin, e jo integrimin e komunitetit serb. Prishtina duhet ta dijë se ruajtja e vendeve të punës është e rëndësishme. Vetë Kosova ka një administratë të mbingarkuar, me më shumë se 80,000 njerëz të punësuar në sektorin publik, dhe përkundër thirrjeve të vazhdueshme nga BE-ja dhe FMN-ja për zvogëlimin e administratës, Prishtina nuk ka ndërmarrë asnjë hap deri tani në këtë drejtim, kryesisht për shkak se ka qenë e vetëdijshme se largimi në masë i punëtorëve do të krijonte kaos dhe nuk do të ishte i favorshëm për partitë politike të koalicionit qeveritar.

- Sipas zyrtarëve qeveritarë, privatizimi i ndërmarrjeve publike në komunat me shumicë serbe do t'i japë prioritet investitorëve serbë të Kosovës. Disa folës kanë thënë se privatizimi i Brezovicës do të duhet të jetë prioritet, pasi që ai do të ofronte mundësi punësimi për shumë njerëz.
- Angazhimi i serbëve të Kosovës në dialogun e Brukselit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthore do të kontribuonte në arritjen dhe implementimin më të mirë të marrëveshjeve. Njëri nga folësit ka thënë se serbët e Kosovës janë lënë jashtë dialogut dhe atyre thjesht u servohen marrëveshje të cilat ata nuk i njohin fare. Poashtu, shumë nga folësit kanë thënë se deputetët serbë në parlamentin e Kosovës do të duhej të angazhoheshin më shumë në politikëbërje.
- Duhet të hapen më shumë zyre në veri të cilat ofrojnë shërbime për serbët atje. Për banorët e Leposaviqit, zyrja më e afërt për të aplikuar për letërnjoftime është 15 kilometra larg. Pa ofruar shumë detaje, shumë nga folësit kanë propozuar që procedurat administrative për marrjen e dokumenteve të lehtësohen.
- Disa nga fondet nga Fondi për Zhvillim për veriu duhet poashtu t'u jepen në formë të granteve organizatave të shoqërisë civile, edhe pse pjesa më e madhe e tyre është e dedikuar për komunat.
- Përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe në Kosovë do t'i kontribuonte normalizimit të marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit, duke përmbushur kështu njërin nga kushtet kyçe për anëtarësim në BE. Shumë nga folësit kanë thënë se pa marrëdhënie të mira fqinjësore, gjasat e Serbisë dhe Kosovës për tu bërë anëtarë të BE-së nuk janë shumë të mira.
- Promovimi i “procesit të depolitizuar” është nevojë urgjente dhe e domosdoshme. Pothuajse çdo çështje është e politizuar, duke komplikuar kështu zgjidhjen e tyre. Ky proces i depolitizimit duhet të fillojë me qeverinë, ku marrëdhëniet mes ministrave shqiptarë e serbë dominohen tërësisht nga politika. Një folës ka thënë se vetë qeveria nuk është e integruar, e aq më pak shoqëria. “Ministrat serbë bëjnë shumëçka që nuk është në linjë me politikën e qeverisë”.

- Beogradi është i përfshirë më shumë se që duhet në politikën e Kosovës, po kjo nuk ndodhë për shkak të serbëve të Kosovës, po për shkak të Prishtinës. Prishtina thotë se puna me Beogradin është më e lehtë, sepse Beogradi “kryen punë”. Një numër folësish kanë thënë se serbët e Kosovës nuk duhet të fajësohen për rolin e shtuar të Beogradit në politikën dhe politikëbërjen e Kosovës.

Pjesëmarrësit janë pajtuar që të organizojnë një komunikim të rregullt mbi çështjet e adresuara në Bruksel, si dhe mbi çështjet lokale. Një nga rekomandimet më të fuqishme dhe konsensuale në këtë takim ka qenë se përfshirja e serbëve të Kosovës në proces është kyç.

Pjesëmarrësit

Qeveria e Kosovës

Isa Mustafa, Kryeministër i Kosovës

Edita Tahiri, Ministre për Dialog, Qeveria e Kosovës

Bajram Gecaj, Zëvendësministër i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe këshilltar i kryeministrit të Kosovës

Valon Murtezaj, Zëvendësministër i Punëve të Jashme, Qeveria e Kosovës

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të serbëve të Kosovës

Milica Andrić, Menaxhere e projektit, OJQ Aktiv, Mitrovicë Veri

Dragiša Krstović, Ish-anëtar, Parlamenti i Kosovës, Leposaviq

Petar Miletić, Ish-nënkryetar, Parlamenti i Kosovës, Prishtinë

Miodrag Miličević, Drejtor ekzekutiv, OJQ Aktiv, Mitrovicë Veri

Dušan Radaković, Drejtor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, Mitrovicë Veri

Nenad Radosavljević, Drejtor, RTV Mir, Leposaviq

Živojin Rakočević, Drejtor, Qendra e Kulturës, Graçanicë

Sanja Sovrlić, Gazetare, RTV Mir, Leposaviq

Rada Trajković, Drejtoreshë ekzekutive, Lezivja Evropiane, Graçanicë

Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës dhe Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Shpetim Gashi, Nënkryetar, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Arber Kuçi, Përfaqësues në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive

Krystyna Marty Lang, Ambasadore e Zvicrës në Kosovë

Roland Salvisberg, Kryesues, Politika e paqes, Divizioni i Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës

Saskia Salzmann, Këshilltare Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës

Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës